



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance Qeveria –Vlada-
Government
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE
CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

RAPORT I VJETOR I PUNËS
PËR VITIN 2012

1 JANAR-31 DHJETOR 2012

Shkurt, 2013
Prishtinë

PËRMBAJTJA**I. HYRJE**

1. Mandati i Agjencisë Qendrore të Prokurimi
2. Çështje të përgjithshme
3. Funksionimi i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
 1. Baza ligjore në fuqi
 2. Struktura organizative e AQP-së
 3. Organogrami i AQP-së
 4. Buxheti

II. FAQJA E INTERNETIT TE AQP-së**III. VEPRIMTARIA E AGJENCISË QËNDRORE TË PROKURIMIT**

1. Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit për autoritetet kontraktuese
2. Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit për projektin e Bankës Botërore
3. Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit për projektin MASHT/DANIDA

IV. NGRITJA E KAPACITETEVE TË RESURSEVE NJERËZORE NË AQP**V. OBJEKTIVAT E AGJENCISË QËNDRORE TË PROKURIMIT PËR VITIN 2013**

I. HYRJE

MANDATI I AQP-së

Blerja e centralizuar dhe mandati i AQP-së trajtohen qartë në nenet 94-97 të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 (më tej LPP).

Para miratimit të Ligjit të ri për Prokurimin Publik në tetor 2011, AQP-ja ka qenë e pavarur dhe është quajtur Agjencia për Prokurimin Publik (APP). Edhe pse mandati i APP-së nuk ka qenë aq i ndryshëm, në praktikë ajo ka nxjerrë vendime dhe mendime për procedurat e prokurimit publik. Si rezultat i heqjes së këtij funksioni të kontrollit që e ka pasur para kësaj ngjarjeje, AQP-ja është në proces të përshtatjes në rolin e saj të drejtpërdrejtë të blerësit kryesor. Ky rol i ofron AQP-së dhe autoriteteve kontraktuese, si edhe operatorëve ekonomikë, mundësi dhe sfida të reja.

Në pajtim me Pjesën VII, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L042), një Agjenci Qendrore e Prokurimit (këtu e tutje AQP), është themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave (këtu e tutje MF). Referimet ndaj “Ligjit” janë referime ndaj Ligjit Nr. 04/L-042, mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

ÇËSHTJET E PËRGJITHSHME

Agjencia Qendrore e Prokurimit, është një agjenci ekzekutive e pavarur që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

AQP, është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të Ministrisë së Financave dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95 Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik mandatohet si organ qendror për prokurime të centralizuara qoftë në nivel qendror (Ministri) apo lokal (Komuna).

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) konform nenit 95 pika 2 e Ligjit te Prokurimit Publik nr. 04/L042 pasi qe Qeveria pas propozimit të Ministrit të Ministrisë së Financave ka miratuar listën e artikujve të përdorimit te përbashkët, zhvillon aktivitetet e prokurimit për kontratat kornize për procedurat e centralizuara. Kryerja e procedurave te centralizuara behet konform legjislacionit qe rregullon çështjet e prokurimit publik ne Kosove dhe Udhëzimit Administrativ te aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve te përbashkët.

Kryerja e aktiviteteve te prokurimit për procedura te centralizuara do te behet ne koordinim te ngushte ne mes te Agjencisë Qendrore te Prokurimit, Ministrisë se Financave dhe Autoriteteve Kontraktuese te cilat janë shfrytëzues te kontratave kornize sipas listës se artikujve te përbashkët.

Agjencia Qendrore e Prokurimit është përgjegjëse për kryerjen e procedurave te prokurimit deri ne nënshkrim te kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës do te behet nga Autoritetet Kontraktuese te cilat i shfrytëzojnë këto kontrata kornize. Te gjitha obligimet monetare qe rrjedhin për këto kontrata do ti paguajnë Autoritetet Kontraktuese nga kodet e tyre buxhetore.

FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT TË AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT

BAZA LIGJORE

Agjencia Qendrore e Prokurimit është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të parapara në Nenin 95 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L-042), në lidhje me zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve te prokurimeve te centralizuara dhe atyre specifike ne Republikën e Kosovës, si në vijim:

- Kryen aktivitete specifike të prokurimit për dhe në emër të autoriteteve kontraktuese, të cilat nuk lejohen të kryejnë prokurimin në fjalë, pas një vendimi përkatës të Ministrit të Ministrisë së Financave. Në këtë rast autoriteti kontraktues në fjalë apo autoritetet nuk kanë ndonjë autoritet për të kryer procedurën e prokurimit në fjalë.
- Kryen prokurime te centralizuara për artikuj të përdorimit të përbashkët specifike, lista e të cilave do të miratohet në formë të një Udhëzimi Administrativ sipas propozimeve të Ministrisë së Financave dhe aprovimin përkatës nga qeveria.
- Kryen prokurimin për çfarëdo mallra, punë ose shërbime sipas kërkesës nga një autoritet kontraktues.
- Asiston autoritetet kontraktuese me kërkesën e tyre, gjatë implementimit të aktiviteteve të prokurimit që udhëhiqen nga vetë autoritetet kontraktuese në të gjitha fazat e aktiviteteve të prokurimit.
Për më shumë , Agjencia Qendrore e Prokurimit asiston cilindo autoritet kontraktues në kryerjen e çfarë do aktiviteti të prokurimit që është duke u kryer, pas një kërkesë përkatëse nga autoriteti kontraktues në fjalë.

STRUCTURA E AQP-së

Struktura e AQP-së është si në vijim:

- Agjencia drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.
- Drejtoratet, sektorët dhe numri i stafit të sugjeruar janë përshkruar në vijim:

Drejtorati i Prokurimeve të Centralizuara

Sektori për prokurime të centralizuara
Sektori për nevojat e AQP-së


Drejtorati i Prokurimeve të Veçanta

Sektori për aktivitete të prokurimit për autoritetet kontraktuese
Sektori për prokurime nga donacionet

Zyre Administrative

Zyrtarë për Financa, Zyrtarë i Personelit, Përkthyes, Zyrtarë i Logjistikës,
Asistente administrative, Arkivues.

3.ORGANOGRAMI I AQP-së



4. BUXHETI I AQP-së

Raporti i AQP-ës për periudhën të përfunduar më 31.12.2012 .Në këtë raport janë pasqyruar në mënyrë analitike por edhe në mënyrë të përmblëdhur të gjitha shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike si për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale.

Qëllimi i raportit në analitikë, është që të jetë i sqaruar çdo detal i shpenzimit për periudhën 01.01.2012-31.12.2012 .

Në fillim të raportit janë shpjeguar qartë buxheti fillestar dhe shfrytëzimi i buxhetit për AQP-ën si dhe shpenzimet dhe progresi në përqindje të shpenzimeve për vitin 2012. Më pas është tabela ku pasqyrohen në mënyrë të përmblëdhur shpenzimet për programin-11000,13000,13200.

4.1. Raporti i buxhetit dhe pagesave për programin: 26300- Agjencioni Qendror i Prokurimit

Duke u bazuar në ligjin e buxhetit: 04/L-079 : buxheti i miratuar për Agjencinë Qendrore të Prokurimit buxheti fillestar është **161.617.00€**. Të pa nën alokuara janë **2,270.00€**, kurse të alokuara për vitin 2012 janë **159,347.00€**

Shpenzimet për vitin 2012 janë: 122,731.03€. Pra nga tabela e mëposhtme shihet se kemi shfrytëzim të buxhetit në shumë prej 70,325.19 € nga fondi paga dhe mëditje, dhe 50,966.07€ nga fondi mallra dhe shërbime, 1,439.77 € nga fondi Shërbime komunale, kurse të pa nën alokuara janë 2,270.00€ të cilat janë ngrirë me vendim të Qeverisë.

Raport buxheti/ 01.01.2012 e deri me 31.12.2012.

	Buxheti fillestar	Pagesat	Mjetet e pa shpenzuara	Progresi
Përshkrimi	Ligji i buxhetit 04/L-079	Mjetet e shpenzuara		në, %
Gjithsejtë	161,617.00	122,731.03	35,086.00	
Pagat dhe shtesat	98,017.00	70,325.19€	27,691.81	72%
Mallrat dhe shërbimet	57,730.00	50,966.07€	6,763.93	89%
Shpenzimet komunale	3,600.00	1,439.77€	2,160.23	40%
Të pa nën alokuara Paga dhe mëditje Mallra he shërbime	2,270.00			

Raport përmbledhës i buxhetit të shpenzuar për periudhën

1 Janar- 31 Dhjetor /2012

Mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit

Përshkrimi i kodit	Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këto shpenzim	5,049.60	2,967.60

Telefonia fikse - PTK

Kodi ekonomik	13250	
Përshkrimi i kodit	Telefonia fikse - PTK	
Përshkrimi	Shuma e zotimit	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	1,439.77	1,439.77

Shpenzimet e telefonisë mobile

Kodi ekonomik	13320	
Përshkrimi i kodit	Shpenzimet e telefonisë mobile - VALA	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	4,480.00	4,480.00

Pajisje deri ne 1,000.00

Kodi ekonomik	13501 deri në 13509	
Përshkrimi i kodit	Pajisje deri 1000€	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Pajisje te IT	4,000.00	3,403.10
Totali për këtë shpenzim	4,000.00	3,403.10

Pije ne Bife

Kodi ekonomik	13620	
Përshkrimi i kodit	Pije ne bife	

Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar

Totali për këtë shpenzim	1,828.70	1,828.80
---------------------------------	-----------------	-----------------

Shpenzimet e akomodimit

Kodi ekonomik	13660-13410-13130	
Përshkrimi i kodit	Shpenzime e Akomodimit	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	7,648.00	5,694.88

Shpenzimet e trajnimit

Kodi ekonomik	13140	
Përshkrimi i kodit	Shpenzimet e trajnimit	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Pagesë për tri bileta aeroplani ne Turqi	861.78	287.26
Pagesë për tri bileta aeroplani ne Turqi		287.26
Pagesë për tri bileta aeroplani ne Turqi		287.26
Kompensim I mjeteve	148.00	148.00
Pagesë për një biletë aeroplani në Itali	635.11	635.11
Pagesë për një biletë aeroplani në Itali	723.00	723.00
Pagesë për dy bileta aeroplani në Bruksel	916.22	458.11
		458.11
Kompensim i mjeteve për udhëtimi ne Bruksel	650.22	322.61
		327.61
Totali për këtë shpenzim	3,934.33	3,934.33

Derivate për vetura

Kodi ekonomik	13780	
Përshkrimi i kodit	Derivate për vetura	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	4,244.36	4,244.36

Mirëmbajtje e automjeteve

Kodi ekonomik	14010	
Përshkrimi i kodit	Mirëmbajtja e automjeteve	
Përshkrimi	Shuma e zotimit	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	2,134.94	2,134.94

Dreka Zyrtare

Kodi ekonomik	14310	
Përshkrimi i kodit	Furnizim me ushqim dhe pije	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	925.00	888.50

Shërbime tjera kontraktuese

Kodi ekonomik	13460-70	
Përshkrimi i kodit	Shërbime tjera kontraktuese	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	20,290.00	16,295.67

Sigurim i Automjeteve

Kodi ekonomik	13951	
Përshkrimi i kodit	Sigurimi i automjeteve	
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	900.00	735.44

Material zyrtar

Kodi ekonomik	13610	
Material zyrtar		
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
Totali për këtë shpenzim	3,000.00	2,744.25

ARKA

Kodi ekonomik	13810	
ARKA		
Përshkrimi	Shuma e zotuar	Shuma e paguar
arka		
Totali për këtë shpenzim	2,500.00	1,614.20

Pagat neto	60,367.67 €
Kontributi i punëtorit	3,348.72
Kontributi i punëdhënësit	3,348.72
Tatimi	3,260.08
Totali	70,325.19 €

Paga dhe shtesa	70,325.19
Mallra dhe shërbime	50,966.07
Komunali	1,439.77
Kapitali	0.00
Totali	122,731.03

III. FAQJA E INTERNETIT TË AQP-së

Ish ueb-faqja e Agjencisë së Prokurimit Publik me ndryshimin e LPP-së dhe transferimin e APP-së në AQP-së u pa e nevojshme që edhe ueb-faqja të **ri-dizajnohet** dhe të përshtatet në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Prandaj lindi si kërkesë që të nis procedura e re e prokurimit për ri-dizajnimin e ueb-faqes elektronike të AQP-së.

Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 25.11.2012 ka bërë njoftimin publik për dhënie kontrate për ueb faqen e internetit. Po ashtu në këtë drejtim është bërë një hap progresiv duke dizajnuar ueb faqen zyrtare të Agjencisë Qendrore të Prokurimit në linkun www.aqp.rks-gov.net.

Gjithashtu në faqen tonë të internetit mund të gjenden të publikuara njoftime të ndryshme rreth punës dhe aktiviteteve të institucionit tonë , raportet vjetore të punës , si dhe informacione tjera mbi legjislacionin në të cilin mbështetet veprimtaria e AQP-së. Të gjithë vizitoret në faqen tonë të internetit i gjejnë informacionet mbi rolin , përgjegjësitë dhe funksionet e Agjencisë Qendrore të Prokurimit . Gjithashtu në ueb-faqen e internetit do të publikohen në mënyrë të rregullt të gjitha vendimet , konkluzionet si dhe rekomandimet rreth plotësim ndryshimit të legjislacionit të prokurimit publik në Kosovë.

Të gjitha këto informacione mund të gjenden në adresën tonë zyrtare elektronike (emailin) infoaqp@rks-gov.net , dhe kjo ueb-faqe elektronike mirëmbahet dhe freskohet çdo kohë dhe dhe njëkohësisht vendosen shkresat në dy gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze.

IV. VEPRIMTARIA AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT

1. Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për Autoritetet Kontraktuese

Më datën 23.01.2012 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit nga Autoriteti Kontraktues Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës ka arritur kërkesa për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit: “ Furnizim me Sulfat Alumini. “

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit kontrata është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të AQP-së , Zyrtari Kryesor Administrativ i AQP-së dhe me datën 09.03.2012 lënda komplet është dërguar për nënshkrim te Ministri i Ministrisë së Financave .Në bazë të nenit 26.2 e LPP-së Nr. 04/L-042 , kontratat me vlera të mëdha të Autoriteteve Kontraktuese është obligim ligjor që kontrata të nënshkruhet edhe nga Ministri i Financave. Lënda me datën 30.05.2012 komplet është kthyer nga Ministria e Financave , ku kontrata nuk është nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Financave dhe e njëjta me datën 08.06.2012 në ueb faqen e KRPP-së është bërë anulimi i aktivitetit të prokurimit.

Me datën 14.02. 2012 në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave është nënshkruar marrëveshja për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit për vitin fiskal 2012 për Autoritetin Kontraktues - Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave .

Për vitin fiskal 2012, për Autoritetin Kontraktues-Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave janë kryer gjithsej 6 (gjashtë) aktivitete të prokurimit. Dy (2) aktivitetet të prokurimit janë kryer me procedurë të hapur, vlerë e mesme, dhe katër (4) aktivitetet të prokurimit janë kryer sipas procedurës Ftesë për Kuotim me vlerë minimale.

Vlera totale e parashikuar për të gjitha aktivitetet e prokurimit është 35,580.00 € , ndërsa vlera totale për të gjitha kontratat e nënshkruara është 29,201.21 € . Vlera e kursyer e mjeteve buxhetore nga aktivitetet e zhvilluara nga AQP-ja të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave është 6,378.79 €. Shprehur në përqindje 17.93 % e mjeteve të kursyera në krahasim me vlerën e mjeteve të parashikuara nga Autoriteti Kontraktues- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave .

Me datën 03.02.2012 në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) është nënshkruar marrëveshja për zhvillimin e të gjithë aktiviteteve të prokurimit për vitin fiskal 2012 .

Për vitin fiskal 2012 për Autoritetin Kontraktues PZAP, janë kryer gjithsej dhjetë (10) aktivitetet të prokurimit. Një (1) aktivitet i prokurimit është kryer me procedurë të hapur , katër (4) aktivitete të prokurimit janë kryer me procedurë – Ftesë për Kuotimin e Çmimeve, katër

(4) aktivitetet e prokurimit janë kryer sipas procedurës së prokurimit Ftesë për kuotim me vlerë minimale dhe një (1) aktivitet i prokurimit është kryer me procedurë të prokurimit Procedurë e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontratë.

Vlera totale e parashikuar për të gjitha aktivitetet e prokurimit është 26,300.00 €, ndërsa vlera totale për të gjitha kontratat e nënshkruara është 17,771.63 €. Vlera e kursyer e mjeteve buxhetore të Autoritetit Kontraktues –PZAP për vitin fiskal është 8,528.37 €. Shprehur me përqindje është 32.43 % e mjeteve të kursyera në krahasim me vlerën e mjeteve të parashikuar nga Autoriteti Kontraktues PZAP.

2. AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR PROJEKTET E FINANCUAR NGA BANKA BOTËRORE

Sipas marrëveshjes me Bankën Botërore dhe Agjencisë Qendrore të Prokurimit-Departamenti i Prokurimeve të Veçanta ka kryer aktivite të prokurimit për projektin e financuar nga Banka Botërore : Business nvironment TA project (IDA H1670) (BETA) . Përfitues i këtij projekti ka qenë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë kryer sipas rregullave dhe procedurave të Bankës Botërore Për këtë projekt gjatë vitit fiskal 2012 janë kryer gjithsej 10 (dhjetë) aktivite të prokurimit .

Me kërkesën e Bankës Botërore dhe Ministrisë së Financave, Departamenti i Prokurimeve të Veçanta ka kryer procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit: Audits of the non-revenue IDA –Financed projects and Grants for the financial year 2011, 2012, 2014, 2015. Procedurat e prokurimit janë kryer sipas rregullave procedurale të Bankës Botërore dhe me kontratë Lump – Sum për pesë (5) vite është shpërblyer kompania FICADEX Alabnia LTD, Tirana , Albania në vlerë prej 29,396.00 euro.

Me kërkesën e Bankës Botërore dhe Ministrisë së Financave, Departamenti i Prokurimeve të Veçanta ka kryer procedurat e prokurimit për auditimin e dy projekteve të financuara nga Banka Botërore. Për këtë procedurë të prokurimit është nënshkruar aneks kontrata me kompaninë FICADEX Albania LTD, Tirana , me vlerë prej 2,300.00 euro.

Për vitin fiskal 2012 me kërkesat e paraqitura nga zyrtaret e Agjencisë Qendrore të Prokurimit për plotësimin e nevojave të tyre të punës zyrtare, sektori për aktivitetet e prokurimit të AQP-së ka zhvilluar gjithsej katër (4) aktivitetet të prokurimit:tri (3) aktivitetet të prokurimit janë kryer me procedurë Ftesë për kuotim çmimi dhe një Ftesë për Kuotim çmimi me vlerë minimale.

Vlera totale e mjeteve të parashikuara për të gjitha aktivitetet e prokurimit , për nevojat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit është 12,900.00 € , ndërsa vlera e përgjithshme e realizuar është 11,540.79 €. Çka do të thotë se nga vlera e parashikuar e mjeteve buxhetore prej 12,900.00 € janë kursyer mjetet buxhetore në vlerë prej 1,359.21 €. Shprehur në përqindje 10.54% e mjeteve buxhetore të kursyera në krahasim me vlerën e parashikuar të mjeteve buxhetore për Autoritetin Kontraktues-Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

3. AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR PROJEKTIN MASHT/DANIDA

Sipas kërkesës së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Projekti MASHT/DANIDA të financuar nga Qeveria e Danimarkës , me datën 25.01.2012 është nënshkruar marrëveshja ne mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe projektit MASHT/DANIDA. Sipas kësaj marrëveshje është paraparë që Agjencia Qendrore e Prokurimit në bazë të kërkesave të projektit MASHT/DANIDA t'i kryej të gjitha aktivitetet e prokurimit në emër të këtij projekti të financuar nga Qeveria e Danimarkës .

Departamenti për Prokurime të Veçanta gjatë vitit fiskal 2012 , në emër të kësaj marrëveshje ka zhvilluar katër(4) aktivitetet te prokurimit me procedurë Ftesë për kuotim çmimi.

Vlera e mjeteve të parashikuara për të gjitha aktivitetet e prokurimit nga ky Departament ka qenë 31,000.00 € , ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara ka qenë 20,842.53 €. Nga të dhënat mund të shihet se kemi arritur që të kursehen mjete të projektit MASHT-DANIDA në vlerë prej 10,157.47 € . Nëse i shprehim në përqindje është 32.77% mjete të kursyera në krahasim me vlerën e mjeteve të parashikuara nga projekti MASHT-DANIDA.

Departamenti për Procedura të Centralizuara gjatë viti fiskal 2012, në bazë të marrëveshjes në mes të MASHT/DANIDA-AQP –së, për këtë projekt ka zhvilluar dhe janë kryer gjithsej nëntë (9) aktivitete të prokurimit. Prej tyre tri (3) aktivitetet janë kryer me procedurë të hapur vlerë të mesme gjashtë (6) aktivitete të prokurimit janë kryer me procedurë – Ftesë për Kuotimin e çmimeve.

Vlera totale e mjeteve të parashikuara nga projekti MASHT_DANIDA është 83,000.00 €, ndërsa vlera totale e mjeteve të realizuara apo kontratave te nënshkruara është 39,862.23 €. Nga të dhënat e shprehura shihet se vlera e mjeteve të kursyera të projektit MASHT-DANIDA është 43,137.77 € . Në qoftë se i shprehim në përqindje është 51.98 % mjete të kursyera në krahasim me vlerën e mjeteve të parashikuara nga projekti MASHT-DANIDA.

Nëse bëjmë një krahasim të vlerës së përgjithshme të mjeteve të parashikuara dhe zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit për projektin MASHT-DANIDA në nivel të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, do të shohim se kemi të bëjmë me një kursim të konsiderueshme të mjeteve të parashikuara të projektit MASHT-DANIDA.

Vlera totale e mjeteve të parashikuara të projektit MASHT-DANIDA për vitin fiskal 2012 është 114,000.00 € , ndërsa vlera e përgjithshme e mjeteve të realizuara apo kontratave të nënshkruara është 68,704.76 €. Nga kjo mund të shihet se vlera e mjeteve të kursyera nga vlera e mjeteve të parashikuara të projektit MASHT-DANIDA është 45,295.24 €. Në qoftë se i shprehim në përqindje është 39.74 % e mjeteve të kursyera në krahasim me vlerën e përgjithshme të mjeteve të parashikuara të projektit MASHT-DANIDA.

V.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË RESURSEVE NJERËZORE NË AQP

Agjencia Qendrore e Prokurimit do të kontribuojë në suaza të kompetencave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga ligji i ri , të veprojë në mënyrën që sistemi i tille te arrije shfrytëzimin sa me racional, efikas, dhe transparent te fondeve publike, të rrisë konkurrencën dhe të respektojë barazinë e pjesëmarrësve në proceset e prokurimit publik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, në pajtim me autorizimet që rrjedhin nga LPP-ja, në bashkëpunim me firmën konsulentë të angazhuar për të asistuar KRPP-në, OSHP, KIPA-në dhe AQP-në me qellim implementimin e Ligjit të Prokurimit Publik si dhe ligjeve tjera ne fuqi janë paraparë trajnime speciale për parimet e prokurimit publik dhe etikes, menaxhimit te materialeve dhe planifikimit, parimet e ligjit te kontratave, përgatitja dhe lansimi i tenderëve, teknikat e negocimit, përgatitja dhe menaxhimi i projekteve kapitale, projektet për pune dhe monitorimi, etj në te cilat AQP-ja do te jete e kyçur ne mënyrë aktive, në ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e prokurimit dhe lëmenjve tjerë të administratës publike. Një vëmendje të caktuar , Agjencia Qendrore e Prokurimit i ka kushtuar edhe ngritjes së resurseve njerëzore , qoftë në fushën e prokurimit publik, financave publike, qoftë në fushën e administratës publike.

Në këtë drejtim, Agjencia Qendrore e Prokurimit ka ofruar asistencën në ngritjen e resurseve njerëzore, duke trajnuar apo duke dërguar në trajnime dhe seminare si në nivelin lokal ashtu në nivelin jashtë vendit, zyrtaret nga fusha e prokurimit publik, nga fusha e financave dhe menaxhimit te parave publike si dhe nga zyra e burimeve njerëzore .

Në vazhdim po japim pasqyrën në mënyrë tabelare të nëpunësve civil të Agjencisë Qendrore të Prokurimit të cilët kanë kryer trajnimet qoftë brenda apo jashtë vendit:

**PLANI VJETOR I TRAJNIMIT TË NËPUNËSVE CIVIL TË AQP-së
PËR PERIUDHEN Shkurt – Dhjetor 2012**

Nevoja për trajnim	Numri i nëpunësve civil qe duhet trajnuar	Përshtatja me prioritet e trajnimit	Titulli i programit /kurset e trajnimit dhe kohëzgjatja e tij (nëse dihet)	Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Trajnime organizuara te jashtë vendit					
Vizitë studimore	3		24-01.2012 28.01.2012	Turqi	
“Procurement management for	1		25.03.2012 06.04.2012	Turino, Itali	

equipment and Works in the World Bank – funded projects”					
Public Procurement under the EU system	2		14.05.2012-18.05.2012	ILO – Torino/Itali	
Trajnim mbi menaxhimin E implementimit te Projekteve për zhvillimin e Bankave	1		18.11.2012-25.11.2012	ILO – Torino/Italy	
“Public Sector Budgeting –What to DO and How to Do it”	2		03.12.2012 07.12.2012	EIPA - Bruksel	
Trajnime te organizuara brenda vendit					
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		07.03.2012 08.03.2012	IKAP	
Trajnime ne fushën e prokurimit	4		13.03.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		21.03.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		23.03.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		26.03.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	1		05.04.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	3		06.04.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		13.04.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		17.04.2012	IKAP	
Trajnim ne fushën e prokurimit	2		19.04.2012	IKAP	

Nga të dhënat e sipërsënuara mund të vërehet se në trajnimet dhe seminarët jashtë vendit , të organizuara nga kompanitë prestigjioze ndërkombëtare siç janë : ILO, SIGMA, PLANETT-i kryesisht kanë marrë pjesë të gjithë zyrtarët e prokurimit publik gjithsej prej tyre nëntë (9) zyrtar të prokurimit. Po ashtu përveç trajnimeve në fushën e prokurimit publik ,janë organizuar edhe trajnime në fushën e menaxhimit të financave publike, personelit dhe administratës si dhe trajnime sipas udhëzuesve dhe praktikave të Bankës Botërore. Të gathë pjesëmarrësit -nëpunësit civil janë pajisur me certifikata përkatës që tregon se nëpunësit civil kanë qenë të përgjegjshëm, aktiv dhe të suksesshëm . Vlera e shpenzimeve të mjeteve publike për ngritjen e kapaciteteve profesionale të nëpunësve civil të Agjencisë Qendrore të Prokurimit

për vitin fiskal 2012 arrin shumën prej 12,596.81€, çka do të thotë se Agjencia Qendrore e Prokurimit për vitin fiskal 2012 duke u bazuar në kapacitetin financiar ka investuar në ngritjen profesionale të resurseve njerëzore të këtij institucioni.

Ndërsa trajnimet brenda vendit qoftë në fushën e prokurimit publik apo në fushën e administratës publike organizohen nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe atë në dy nivele :

- niveli bazik – fillestar dhe
- niveli i avancuar.

Në fund të trajnimeve të gjithë zyrtarët e suksesshëm të prokurimit pajisen me certifikata të prokurimit në nivelin përkatës të trajnimit.

I tërë dokumentacioni nga fusha e prokurimit publik dhe administrata janë përgatitur në tri gjuhë: gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze.

VI.

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT

Planifikimi i prokurimit është proces i ndërmarrë nga Autoritetet Kontraktuese për të planifikuar aktivitetet e prokurimit për një periudhë kohore prej 12 muaj në bashkëpunim me njësitë kërkuuese dhe Departamentin e Buxhetit. Përgatitja e planit vjetor të prokurimit përfshinë të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues parasheh t'i zhvilloi gjatë vitit të ardhshëm fiskal. Eliminon nevojën për prokurime emergjente apo përjashtime: grumbullon kërkesat kur është e mundur, për të fituar vlerën për parane dhe për të reduktuar kostot e prokurimit; mundëson identifikimin e kontratave kornizë për të ofruar mënyrë efektive, efektive në kosto dhe fleksibilitet për prokurimin e punëve, shërbimeve ose furnizimeve të cilat kërkojnë vazhdimisht ose në përsëritje gjatë një periudhe të caktuar kohore; dhe eviton ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura. Planifikimi i prokurimit do të përgatitet nga secili Autoritet Kontraktues. Në rast të autoritetit publik ose ndërmarrjes publike, AK në fjalë do të dorëzojë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, këtu e tutje "AQP", me shkrim planifikimin preliminar të prokurimit. Planifikimi preliminar i prokurimit do të dorëzohet në AQP jo më pak se 60 ditë para fillimit të vitit fiskal – që do të thotë jo më vonë se 1 nëntor të secilit vit.

Planifikimi preliminar i prokurimit do të identifikojë, në detaje të mjaftueshme, të gjitha furnizimet, shërbime dhe punët që AK (Njësia Buxhetore) parasheh të prokurojë gjatë vitit të ardhshëm fiskal. Brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, secili AK (Njësi Buxhetore), i cili është autoritet publik ose ndërmarrje publike, do të përgatit dhe do të dorëzojë në AQP, me shkrim, planifikimin final të prokurimit.

Qëllimi i ofrimit të planifikimit paraprak dhe final në AQP është që t'i ofrohet AQP-së informacion i tërësishëm për prokurimet e planifikuara në Kosovë si tërësi, në mënyrë që AQP të identifikojë artikujt e përdorimit të zakonshëm dhe objekte tjera dhe artikujt të cilët mund të blihen në mënyrë më efektive përmes aplikimit të procedurës së përbashkët apo të konsoliduar të prokurimit ose përmes përdorimit të kontratave qendrore kornizë.

AQP do të shqyrtojë dhe identifikojë artikujt e përdorimit të zakonshëm për prokurim përmes procedurës së përbashkët të prokurimit në emër të AK-ve dhe do të dorëzojë listën të Ministri i Ministrisë së Financave "MeF". Ministri i MeF do të dorëzojë listën në Qeveri për aprovim.

Qeveria sipas propozimit nga MeF do të krijoj një listë të artikujve të përdorimit të përbashkët ose artikujve të përdorimit të zakonshëm për prokurimin e të cilave ka përcaktuar AQP-në. Një listë e tillë do të miratohet nga Qeveria në formë të një Udhëzimi Administrativ i cili do të publikohet në media dhe të vihet në dispozicion në faqe të internetit të KRPP-së.

Të gjitha kontratat e udhëhequra nga AQP përmes procedurave të zakonshme të prokurimit janë të obligueshme për të gjitha AK-të, përveç Ndërmarrjeve Publike për të cilat Ministri i MF duhet të marr aprovimin e bordit relevant mbikëqyrës. Kjo do të thotë që AK nuk do të ndërmarrë aktivitete të prokurimit publik për artikujt e publikuar në Udhëzimin Administrativ. Planifikimet e prokurimit nuk do të publikohen dhe nuk janë në dispozicion për publikun. Asnjë informatë mbi aktivitetet e planifikuara të prokurimit të AK nuk lejohet që të publikohen apo të komunikohen për askënd para publikimit të njoftimeve standarde (njoftimin indikativ apo njoftimin për kontratë). Arsyeja për këtë, është që të ruhet parimi i trajtimit të barabartë, që do të thotë në këtë rast që informacionet mbi një aktivitet të caktuar të prokurimit do të vihen në dispozicion të OE-ve në të njëjtën kohë për të gjithë.

Planifikimi i prokurimit duhet të jetë konform buxhetit të AK për vitin fiskal në fjalë. Kur bëhet fjalë për kontrata shumë-vjeçare, duhet të ketë bazë të arsyeshme që aprovimi i buxhetit do të bëhet për AK në vitet e ardhme përkatëse fiskale.

Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do t'i nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat (përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.

Në vazhdim do japim një pasqyrë të shkurtër për të gjitha autoritetet Kontraktuese goftë në nivelin qendror apo lokal, si dhe kompanitë publike të cilat kanë dorëzuar Planifikimet paraprake dhe përfundimtare në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Sipas të dhënave të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Sistemin e Prokurimit Publik të Kosovës janë 161 Autoritete Kontraktuese të cilat shfrytëzimin e mjeteve publike e bëjnë duke iu nënshtruar rregullave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, shifër kjo e cila mund të jetë relative.

Sipas të dhënave në Agjencinë Qendrore të Prokurimit janë dorëzuar gjithsej 104 **Planifikime Preliminare** sipas autoriteteve kontraktuese dhe atë:

- Zyra e Presidencës.....	1 (një)
- Zyra e Kuvendit.....	1 (një)
- Zyra Kryeministrit	1 (një)
- Ministrinë.....	13 (trembëdhjetë)
- Komunat.....	18 (tetëmbëdhjetë)
- Institucionet e pavarura.....	33 (tridhjetetë)
- Agjencitë.....	7 (shtatë)
- Kompanitë Publike.....	18(tetëmbëdhjetë)
- Spitalet dhe Qendrat mjekësore.....	12(dymbëdhjetë)
Gjithsejtë:	104 (njëqindekatër).

Nga gjithsej 161 Autoritete Kontraktuese , në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Planifikimet Preliminare i kanë dorëzuar 104 sosh. Prej tyre 66 autoritetet kontraktuese i kanë dorëzuar me kohë ndërsa 44 autoritete kontraktuese i kanë dorëzuar me vonesë.

PLANIFIKIMI PËRFUNDIMTAR

Nga gjithsej 151 Autoritete Kontraktuese , në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Planifikimet Përfundimtare i kanë dorëzuar 139 sosh. Prej tyre 83 autoritete kontraktuese i kanë dorëzuar me kohë ndërsa 56 autoritete kontraktuese i kanë dorëzuar me vonesë.

DEKLARATA E NEVOJAVE DHE PËRCAKTIMI I NEVOJAVE TË DISPONUESHMËRISË SË FONDEVE

Në bazë të paragrafit 6 (gjashtë) të nenit 9 të LPP-së, autoritetet kontraktuese qofshin ato autoritetet publike apo ndërmarrje publike, nëse lendet e aktiviteteve të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues i cili është dorëzuar në AQP sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji , ZKA është i obliguar të dërgojë në AQP-ë një kopje të deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve së paku pesë (5) ditë para se zyrtari autorizues të autorizojë zyrtarin e prokurimit për fillimin e një aktivitetit përkatës të prokurimit.

Në bazë të dhënave në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, sipas autoriteteve kontraktuese dhe kompanive publike për vitin 2012 janë pranuar gjithsej 409 Deklarata të Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve. Në vazhdim po japim numrin e Deklaratave dhe Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve sipas autoriteteve kontraktuese dhe ndërmarrjeve publike:

- Agjencitë	54
- Kompanitë publike.....	48
- Institucionet e pavarura.....	102
- Komunat.....	164
- Ministritë.....	37
- Spitalet.....	04

VII.**OBJEKTIVAT E AQP**

Objektivat ose politikat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit(AQP) në zhvillimin e mëtutjeshëm janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Objektivi kryesor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit është funksionimi më i mirë dhe i pavarur i institucionit në shërbim të Autoriteteve kontraktuese. Rëndësi të veçantë do të kushtohet profesionalizmit efikasitetit dhe ndërgjegjësimit në zhvillimin dhe kryerjen e aktiviteteve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit..

Strukturimi organizativ i AQP-së në pajtim të plotë me ndryshimet dhe amandamentimet e LPP-se me qëllim të funksionalizimit dhe ngritjes së efektivitetit për përmbushjen e kërkesave që rrjedhin pas ndryshimeve të LPP-së . Agjencia Qendrore e Prokurimit parasheh të themelohen 4 sektorët e AQP-së në bazë të Ligjit të ri të Prokurimit Publik të Kosovës.

Në bazë të ligjit nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik nëni 94 themelohet Agjencia Qendrore e Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Financave,AQP do të zbatoj dhe të kryej funksione dhe përgjegjësi të specifikuar në këtë ligj. Për punën dhe veprimtarinë e saj AQP nëpërmjet raporteve vjetore është e obliguar të informon Ministrinë e Financave lidhur me zhvillimet në sistemin e Prokurimit Publik dhe të zbatimit të Ligjit. Në këtë drejtim AQP do të përpiqet të ofroj Ministrisë së Financave informacione të nevojshëm për maksimalizimin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore posaçërisht për aplikimin e kontratave kornizë (afatgjata dhe të centralizuara). Në themelimin e sektorëve profesionale për zbatimin e projekteve speciale sidomos ato të Bankës Botërore për të cilat Ministria e Financave do të besoj AQP-se si dhe sektorëve tjera profesionale varësisht nga përgjegjësit dhe kërkesat e LPP-se të cilat i adresohen AQP-së.

AQP, në pajtime me autorizimet që rrjedhin nga LPP Në bashkëpunim me firmën konsulentë të angazhuar për të asistuar KRPP-në,OSHP, KIPA-në dhe AQP-në me qëllim implementimin e ligjit janë të parapara trajnime speciale për parimet e prokurimit publik dhe etikës, menaxhimit të materialeve dhe planifikimit, parimet e ligjit të kontratave, përgatitja dhe lansimi i tenderëve, teknikat e negocimit, përgatitja dhe menaxhimi i projekteve kapitale, projektet për punë dhe monitorimi, etj në të cilat AQP- do të jete e kyçur në mënyrë aktive, në komitetin drejtues.

Në funksion të transparencës, efikasitetit , kursimit të mjeteve buxhetore , bashkëpunimit më efikas me autoritetet kontraktuese, Agjencia Qendrore e Prokurimit për të ardhmen , do të kushtojë vëmendje të posaçme ndë të tjera edhe këtyre objektivave :

1. Për vitin 2013 , sfidë e veçantë për AQP-në do të jetë përgatitja e listës së artikujve të përdorimit të përbashkët dhe dorëzimi i sajë në një kohë sa më të shpejtë në Ministrinë e Financave.
2. Agjencia Qendrore e Prokurimit vëmendje të veçantë do ti kushtojë ngritjes së kapaciteteve profesionale të kuadrove , me qëllim të ngritjes së besueshmërisë së autoriteteve kontraktuese dhe palëve me interes, në veprimtarinë e institucionit të sajë .
3. Krijimin e kushteve të nevojshme për punë sa më të suksesshme, duke u orientuar në rritjen e stafit profesional në fushën e prokurimit publik .
4. Angazhimin e ekspertit ndërkombëtar dhe atij nacional në fushën e prokurimit publik , për zhvillimin e procedurave të centralizuara do të paraqesin një ndihmesë të veçantë për zyrtaret e prokurimit në veçanti dhe AQP-në si institucion që është mandatar si organ qendror për blerje të centralizuara me Ligjin e ri të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042.

Politikat kryesore

Politikat kryesore të AQP-së janë të orientuara në zbatimin sa më të mirë dhe të drejtë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë NR/04/L-042 si dhe të ligjeve të buxhetit që janë fuqi, dhe atë me sa vijon:

1. Krijimi i kushteve për implementimin e ligjit dhe zbatimin e tij në praktikë
2. Zbatimin e ligjit rreth shfrytëzimit të buxhetit në mënyrë sa më të racionalë dhe të transparente në harmoni me ligjet e buxhetit në fuqi.
3. Ngritjen e burimeve njerëzore dhe profesionale në AQP
4. Përgatitja e planit kesh-it dhe dorëzimi i tij në kohë të caktuar në MF
5. KASH-i
6. Respektimi i afateve kohore rreth qarqeve buxhetore
7. Dorëzimi i raporteve të buxhetit në përfundim të vitit fiskal.
8. Përgatitja e pasqyrave financiare sa më të sakta dhe dorëzimi i tyre brenda afatit kohor të parapare me udhëzimet administrative në fuqi

Mursel Racaj

Drejtor Ekzekutiv i AQP-së